

Njoftim

Në datën **21.04.2023 ora 08:45**, në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr.“IsmailQemali”, Tiranë, do të hidhet shorti për përcaktimin e trupit gjykues për gjykimin e kërkesëpadisë Nr.15 Regj.Themeltar, Datë 20.04.2023 Regjistrimi, me:

Paditës: KOALICIONI “BASHKË FITOJMË”.

I paditur: Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve - KQZ.

Objekti: Ndryshimin e Vendimit nr. 61, datë 19.04.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur:

Ndryshimin e vendimeve nr. 361 dhe 362 të KSH, datë 15.04.2023, duke ndryshuar përmbajtjen e fletës së votimit për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, si dhe për 60 bashkitë e tjera në vend, duke vendosur përbri emrit të Koalicionit “Bashkë Fitojmë” emrin e z.Sali Berisha.

Tiranë, më 20.04.2023.

Gjykata Administrative e Apelit